

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

(HORIZON CONSTRUCTION)

Kreu I

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më date 17.01.2025 ortaket themelues Joan Kokeri ,lindur me 10.12.1990 mbajtes i ID me Nr. Personal J 01210056 M dhe Egert Çollaku, lindur me 02.07.1975 mbajtes i ID me Nr. Personal H 50702117 U kane vendosur themelin e shoqerise **Horizon Construction** me termat si me poshte:

Dispozita te pergjithshme

Shoqeria **Horizon Construction** rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve,te organeve te saj, llojin e shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj ,marredheniet me te punesuarit , duke u bazuar ne ligjin NR.9901, date 14.04.2008''Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare'' si dhe ligjin nr.10.091 date 5/3/2009 si dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojn marredheniet e Shoqerive Tregtare .

Neni 2:

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Objekti i Veprimtarisë:

- Import, eksport, tregetim me shumice dhe/ose pakice te mallrave te ndryshem, si dhe cfare dolloj aktiviteti industrial, tregtar, financiar;
- Nxjerra, prodhimi, shfrytezimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit, perfshire lende te para, inerte, etj.
- Te gjitha aktivitetet e nevojshme ne fushen e studimit, projektimit, ndertimit, testimit dhe kolaudimit, duke perfshire por pa u kufizuar ne:
 - o ndertim dhe zhvillim,
 - o punime te pergjithshme ndertimi,
 - o punime speciale ndertimi, mbi dhe nen toke,
 - o veprimtari prodhimi, ndertimi e montimi te cfaredo lloji qofshin,
 - o projektim dhe ndertim i cdo lloj objekti dhe ndertese, instalimeve, sistemeve dhe infrastrukture inxhinierike, godina banimi, civile, industriale, qeveritare, kultutore, ushtarake, te rendesise se vecante, sherbime, etj.,
 - o Infrastruktura kryesore dhe ndihmese,
 - o ujesjellesa, kanalizime, sisteme vaditjeje, kanale kulluese, drenazhe, rezervuare, depo uji, impiante, etj.,
 - o diga dhe tunele hidroteknike,
 - o punime topogjeodezike,
 - o shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë,
 - o ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane,
 - o Impante teknologjik, termike dhe të kondicionimit,
 - o Impante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni,



- Impiantë të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.,
- stacione karikimi te automjeteve elektrike dhe hibride,
- rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, ura, tunele, punime rrugore, sinjalistike,
- naftesjellesa, vajsjellesa, gazsjellesa, instalime dhe impiante elektrike, teknike e teknologjike, impiante fotovoltaike, nyje të trajtimit të ujrave të zeza, impiante pastrimi, stacione elektrike, etj.,
- punime riparimi, rikonstruksione, restaurime etj.,
- infrastruktura kryesore dhe ndihmese portuale dhe aeroportuale, ndertimi i ndertesave, infrastrukture, rrjeteve, dhe sistemeve te nevojshme, pista aeroportuale,
- mbrojtje lumore, vaditje, kanale kulluese,
- ndertime detare dhe punime thellimi në ujë,
- ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike,
- ndërtimi për n/stacionet, kabinet e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë,
- shërbime administrimi dhe mirëmbajtjeje,
- punime të inxhinierisë së mjedisit,
- administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projekte e zhvillimit në zonat rezidenciale dhe te turizmit për qëllime rekreative, restorative dhe akomoduese, qeramarrje, qeradhenie, ndermjetesim, manaxhim pronash te luajtshme dhe te paluajtshme, per vete dhe per te trete.
- menaxhimi i zbatimit te projekteve, per vete dhe per te trete,
- investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi,
- shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti,
- kryerjen e aktivitetit të menaxhimit të riskut dhe shërbimeve këshillimore të sigurisë dhe shëndetit në punë,
- Ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e biznesit, ndertimit, menaxhimit, taksave etj. mbikqyrje dhe kolaudim punimesh
- Vleresim te pasurive te paluajtshme dhe cdo lloj veprimtarie apo transaksiioni tjeter qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te cfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arrijen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqerise, realizimi i punimeve, sherbimeve, aktivitetit tregtar, finanziar, import & eksport, dhe cdo gje tjeter qe nuk ndryshon aktivitetin paresor te Shoqerise dhe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Shoqeria do te kryeje pa kufizim çdo aktivitet tjeter te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë **Horizon Construction** do të jetë e **pakufizuar** dhe fillon me regjistrimin eshoqerise ne RegjistrinTregtar.

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisëndodhet ne adresën: “**Frederik Shiroka**” pallati nr 1, shkalla 3, Zyra 2, Njesia **Bashkiake nr 7, TIRANE**,




Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (njeqind) Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: Joan Kokeri ,lindur me 10.12.1990 mbajtes I ID me Nr. Personal J 01210056 M, Zoteruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë , me vlerë nominale prej 60 (gjashtedhjete) leke

2. Ortaku themelues: Egert Collaku, lindur me 02.07.1975 mbajtes I ID me NR. Personal H 50702117 U Zoteruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë , me vlerë nominale prej 40 (dyzet) leke

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve te pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshtesa statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarresi shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" tëkësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dh e prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person iitetë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshine dhe mbledhjet vijuese me tënëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.



Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 tëligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkressë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo mëvonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dh eprishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Afati i e mërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.** Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Administratoret e shoqerise per një periudhe 5 vjecare jane te dy se bashku:

1- Joan Kokeri, lindur me 10.12.1990 mbajtes i ID me Nr. Personal J 01210056 M, **Madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar.**

2.- Egert Collaku, lindur me 02.07.1975 mbajtes i ID me NR. Personal H 50702117 U, **Madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar.**

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një system paraljmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyrat të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër active blerje ose shitje, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht ose vec e vec shoqërinë.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faj të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

Solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mire të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte paguese për të shlyer detyrimet;

Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshir edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti finansiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18


Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.



Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'idrejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Per regjistrimin e shoqerise prane QKB autorizohet administrati JOAN KOKERI.

ORTAKET E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

HORIZON CONSTRUCTION

Joan KOKERI



Egert COLLAQU

